



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

01-1886

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-133515/24 dt. 10.10.2024, të kërkuetit/ pronarëve Sokol Gashani nga Glllogoci, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën e përkoshme me destinim: depo, afarizëm dhe pikë e furnizimeve me karburant, e ndërtuar në kuadër të “Planit Zhvillimor Urban” në Prishtinë, në rr. “Aleks Çaçi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 15.10.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuetit/ pronarit Sokol Gashani nga Glllogoci, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-133515/24 dt. 10.10.2024, përdorimi i ndërtesës së përkoshme me destinim: depo, afarizëm dhe pikë e furnizimeve me karburant me etazhitet P+0, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05 Nr. 351/02-159776/23 dt. 17.11.2023, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelen kadastrale nr. 10387-1, ZK Prishtinë, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Aleks Çaçi” ku ka hyrjet daljet me numrin: 40/1 dhe 40/2, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkueti/ pronari Sokol Gashani nga Glllogoci, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-133515/24 dt. 10.10.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën e përkoshme me destinim: depo, afarizëm dhe pikë e furnizimeve me karburant, me etazhitet

P+0, e ndërtuar në kuadër të “Planit Zhvillimor Urban” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parces kadastrale nr. 10387-1, ZK Prishtinë, sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05 Nr. 351/02-159776/23 dt. 17.11.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-123946/24 dt. 20.09.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; **Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore;** Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Endrit Thaqi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Besim Duraku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Gëntrit Ademi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Edmond Osmani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Artan Dashi; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Nazmi S. Bajrami B.I.; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa e përkoshme afariste/depo mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa me karakter të përkoshëm me destinim: depo, afarizëm dhe pikë e furnizimeve me karburant, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën e përkoshme me destinim: depo, afarizëm dhe pikë e furnizimeve me karburant

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 391/02-133515/24 DT. 15.10.2024**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



